

VENDIM
Nr. 265, datë 7.5.2014

**PËR PËRJASHTIMIN NGA DETYRIMI PËR PAJISJE ME LEJE PUNE DHE CERTIFIKATË
REGJISTRIMI NË PUNË PËR SHTETASIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE SHTETASIT E
REPUBLIKËS SË SERBISË TË PËRKATËSISË ETNIKE SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 71, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përrjashtimin nga detyrimi për pajisje me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e Republikës së Serbisë të përkatësisë etnike shqiptare, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët gëzojnë të drejtën e punësimit e të vetëpunësimit, sikurse edhe shtetasit shqiptarë, përjashtuar rastet kur punësimi lidhet posaçërisht me pasjen e shtetësisë shqiptare, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Deklarimi për punësimin e shtetasve, sipas përcaktimit të pikës 1, bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga vetë shtetasi apo nga punëdhënësi i tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama